**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**Komuna e Mitrovicës së Jugut**
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E MITROVICËS-OPSTINA MITROVICA
01-052/01-0046374/24
10.07.2024

**Zyra për Komunikim me Publikun**

## Raport për trajtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike Janar- Qershor 2024

Regjistri i evidencës së kërkesave të pranuara dhe përgjigjeve të dhëna për qasje në dokumentet publike të Komunës së Mitrovicës duke u bazuar në Ligjin Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike dhe Planin e Veprimit për Transparencë në Komunën e Mitrovicës së Jugut 2023/2027.

Gjatë kësaj periudhe gjashtë mujore Janar- Qershor 2024, Zyra për Komunikim me Publikun, ka pranuar gjithsej **32** kërkesa për qasje në dokumente publike, ku **16** prej tyre janë parashtruar në formë elektronike dhe **16** në formë fizike.

Të gjitha kërkesat e parashtruara për Komunën e Mitrovicës kanë marrë përgjigje brenda afatit të paraparë ligjor, ku **21** prej tyre kanë marrë qasje të plotë, ndërsa **10** qasje të pjesshme.

Të dhënat në formë të detajuar për secilën kërkesë për këta tre muaj mund ti gjeni në tabelat e mëposhtme.

| Nr. | Parashtruesi i kërkesës | Mënyra e parashtrimit të kërkesës | Data e parashtrimit | Data e dërgimit tek drejtoria/ zyrtari përkatës për | E vlerësuar si: | Data e kthimit të përgjigjes | Numri i dokumenteve të kërkuara |
|---|---|---|---|---|---|---|---|

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | [illegible] | | | |
| 1. | Ensar Suma, gazetar në Portalin Online Vëzhguesi.com<br><br>01-034/01-000727/24 | Elektronike | 04.01.2024 | 04.01.2024 | Qasje e Plotë | 24.01.2024 | Pala ka kërkuar qasje në dokumente zyrtare që kanë të bëjnë me shpenzimet e udhëtimeve zyrtare. drekave dhe darkave për vitin 2023 të Kabinetit të Kryetarit dhe Drejtorëve komunal. Kërkesa është shqyrtuar nga Njësia përgjegjëse (Drejtoria për Buxhet dhe Financa) me afat shtesë prej 15 ditësh sipas Ligjit Nr.06/L-081 për qasje në dokumente publike. |
| 2. | Rrezarta Prekazi,<br><br>Studente<br><br>16-034/01-0001891/24 | Fizike | 10.01.2024 | 10.01.2024 | Qasje e Plotë | 12.01.2024 | Pala ka kërkuar qasje në informata zyrtare që kanë të bëjnë me numrin për familjet me asistencë sociale dhe familjet që kanë fëmijë me nevoja të veçanta për periudhën 2013-2023. |
| 3. | Shemsi Jashari, drejtor ekzekutiv në "Demokracia Fillon Këtu – DFK"<br><br>01-034/01-0003853/24 | Elektronike | 16.01.2024 | 22.01.2024 | Qasje e Plotë | 29.01.2024 | Pala ka kërkuar qasje në Informata që kanë të bëjnë me caktimin e Zyrtarit Përgjegjës për Konsultime Publike, planifikimi i konsultimeve publike në planin e komunës dhe planin për komunikim publik, si dhe pyetje tjera që kanë të bëjnë me transparencën komunale të punës së Ekzekutivit dhe Legjislativit të Komunës duke përfshirë proceset e mbajtjes së diskutimeve publike. Kërkesa në fjalë është shqyrtuar me afat shtesë prej 15 ditësh sipas Ligjit Nr.06/L-081 për qasje në dokumente publike. |
| 4. | Rushit Rushiti, qytetar nga Leposaviq<br><br>01-034/01-0005163/24 | Fizike | 23.01.2024 | 24.01.2024 | Qasje e Plotë | 26.01.2024 | Pala ka kërkuar qasje në dokumentet lidhur me përzgjedhjen e z. Selim Peci, anëtar i komisionit për mosvijimin e mësimit të nxënësve. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 5. | Rushit Rushiti, qytetar nga Leposaviq<br><br>01-034/01-0009393/24 | Fizike | 07.02.2024 | 07.02.2024 | Qasje e Pjesshme | 21.02.2024 | Pala ka kërkuar qasje në dokumente zyrtare dhe informata lidhur me lëndën e djalit të tij z.Granit Rushiti, i cili ka qenë kandidat në konkursin për ndarjen e bursave nga Komuna e Mitrovicës, si dhe qasje për kandidatët e tjerë. Kërkesa në fjalë është trajtuar me afat shtesë prej 15 ditësh sipas Ligjit Nr.06/L-081 për qasje në dokumente publike. |
| 6. | Mustafë Shala, qytetar nga Mitrovica<br><br>01-034/01-000968/24 | Fizike | 07.02.2024 | 07.02.2024 | Qasje e Pjesshme | 20.02.2024 | Pala ka kërkuar qasje lidhur me dokumentet e kandidatëve që kanë aplikuar në konkursin për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve në N.P.L "OMNI SPORT". Kërkesa është trajtuar me afat shtesë prej 15 ditësh duke u bazuar në Ligjin për qasje në dokumente publike. |
| 7. | OJQ "EC Ma Ndryshe"<br><br>01-034/01-0011435/24 | Elektronike | 13.02.2024 | 13.02.2024 | Qasje e Plotë | 20.02.2024 | Pala ka kërkuar informata në Komunën e Mitrovicës së Jugut lidhur me numrin e aseteve hipotekare të regjistruara për periudhën Janar 2023- Dhjetor 2023 dhe cili aset është lënë më së shumti në hipotekë. |
| 8. | Rushit Rushiti, qytetar nga Leposaviq<br><br>01-034/01-0016618/24 | Fizike | 05.03.2024 | 06.03.2024 | Qasje e Plotë | 11.03.2024 | Pala ka kërkuar qasje në dokumentet publike lidhur me lëndë të QPS-së për shërbimet sociale. |
| 9. | Rushit Rushiti, qytetar nga Leposaviq | Fizike | 15.03.2024 | 19.03.2024 | Qasje e Plotë | 21.03.2024 | Pala ka kërkuar qasje në dokumentet publike lidhur me listën e cila është dërguar në DMZP-MPB, për zbritjen e koeficientit për z. Rushit Rushiti dhe disa zyrtarë tjerë të Qendrës për Punë Sociale. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 04-030/01-0019213/24 | | | | | | |
| 10 | OJQ "Mundësia"<br><br>01-034/01-0022816/24 | Elektronike | 02.04.2024 | 02.04.2024 | Qasje e Plotë | 08.04.2024 | Pala ka kërkuar qasje në Informata dhe përgjigje në disa pyetje që ndërlidhen me vlerësimin e transparencës komunale për periudhën Janar- Dhjetor 2023. |
| 11 | Agon Prekazi<br><br>01-034/01-0024864/24 | Fizike | 11.04.2024 | 15.04.2024 | Qasje e Plotë | 16.04.2024 | Pala ka kërkuar qasje në dokumente zyrtare që kanë të bëjnë me Vendimin për Anulimin e Konkursit për pozitën; Zyrtar për Teknologji Informative, me Nr. Reference RN00012864 dhe Nr. Protokolli 10-111/01-0085415/23, dt. 24.11.2023. |
| 12 | Nora Jusufi, Konsulente e Jashtme për "Finance Think" Institut për kërkime ekonomike dhe politika në Maqedoninë e Veriut<br><br>01-034/01-0028846/24 | Elektronike | 26.04.2024 | 26.04.2024 | Qasje e Plotë | 16.05.2024 | Pala ka kërkuar informata që kanë të bëjnë me programet apo masat për dhënien e granteve/subvencioneve në kulturë, rini dhe sport, mirëqenie sociale apo të tjera për vitet 2019-2023, masat në kuadër të Programit për Rimëkëmbje Ekonomike. Kërkesa e parashtruar është trajtuar me afat shtesë prej 15 ditë sipas Ligjit Nr.06/L-081 për qasje në dokumente publike. |
| 13 | Altina Kamberaj, hulumtuese<br><br>01-034/01-0029306/24 | Elektronike | 29.04.2024 | 29.04.2024 | Qasje e Pjesshme | 16.05.2024 | Pala ka kërkuar qasje në informata dhe dokumente publike që kanë të bëjnë me Shpenzimet Publike në arsimin publik të realizuara më specifikisht në dy nuvelet e arsimit, atë primar dhe sekondar në nivelin lokal (Komunën e Mitrovicës së Jugut), mundësisht për vitet 2008-2023. Kërkesa në fjalë është trajtuar me afat shtesë prej 15 ditësh sipas Ligjit. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 14 | Rudina Hasimja, hulumtuese në Fondacionin Kosovar për Shoqëri Civile<br><br>01-034/01-0029312/24 | Elektronike | 29.04.2024 | 29.04.2024 | Qasje e Plotë | 16.05.2024 | Pala ka kërkuar qasje në informata që kanë të bëjnë me subvencionimin e OJQ-ve për vitin 2023 nga Komuna e Mitrovicës së Jugut. |
| 15 | Gazeta Online Veriu.info<br><br>01-034/01-0029292/24 | Elektronike | 29.04.2024 | 29.04.2024 | Qasje e Pjesshme | 03.05.2024 | Pala ka kërkuar qasje në dokumente publike për kontratën për dhënie në shfrytëzim të tokës për N.T.P "Tropik" për ndërtimin e parkingut nëntokësor përball Komunës, që është dhënë në shfrytëzim në vitin 2018, duke përfshirë të gjitha shkresat e lëndës për dhënien në shfrytëzim të kësaj prone, përfshirë edhe Planin e Operatorit Ekonomik për këtë parking. |
| 16 | Lavim Hyseni, qytetar nga Mitrovica<br><br>01-034/01-0029710/24 | Fizike | 29.04.2024 | 02.05.2024 Zyra për Komuniki me Publikun ka pranuar kërkesën<br><br>02.05.2024 | Qasje e Plotë | 08.05.2024 | Pala ka kërkuar informata lidhur me konkursin për pozitën Inspektor i Tregut dhe atë për kualifikimin e kandidatëve të cilët kanë kaluar verifikimin paraprak. |
| 17 | Bletë Rashiti, Qendra për Informim, Kritikë dhe Aksion-"QIKA"<br><br>01-034/01-0029698/24 | Elektronike | 30.04.2024 | 30.04.2024 | Qasje e Plotë | 03.05.2024 | Pala ka kërkuar qasje në informata dhe dokumente zyrtare lidhur me subvencione, transfere dhe dëgjimet publike të ndara sipas gjinisë. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 18 | Lavdim Hyseni, qytetar nga Mitrovica<br><br>01-034/01-0029884/24 | Fizike | 02.05.2024 | 03.05.2024<br><br>Zyra për Komunikim me Publikun ka pranuar kërkesën<br><br>03.05.2024 | Qasje e Plotë | 08.05.2024 | Pala ka kërkuar qasje në informata lidhur me konkursin për pozitën Inspektor i Mbrojtjes së Mjedisit dhe atë përvojën e punës së kandidatëve të cilët e kanë kaluar verifikimin paraprak. |
| 19 | Berat Hasani<br><br>01-034/01-0030358/24 | Elektronike | 03.05.2024 | 03.05.2024 | Qasje e Plotë | 08.05.2024 | Pala ka kërkuar qasje në informata lidhur me përvojën e punës për 2 (dy) kandidatët në Konkursin për pozitën Inspektor i Mbrojtjes së Mjedisit. |
| 20 | Blerim Meholli<br><br>01-034/01-0030964/24 | Fizike | 07.05.2024 | 07.05.2024 | Qasje e Pjesshme | 10.05.2024 | Pala ka kërkuar qasje në informata lidhur me konkursin me Nr. Ref. 00013588 për pozitën Inspektor i Mbrojtjes së Mjedisit dhe atë në dosjen e dy kandidatëve të cilët kanë kaluar verifikimin paraprak. |
| 21 | Aolta Bajrami, hulumtuese në<br><br>Rrjeti i OJQ-ve "AVONET"<br><br>01-034/01-0031107/24 | Elektronike | 08.05.2024 | 08.05.2024 | Qasje e Plotë | 14.05.2024 | Pala ka kërkuar qasje në dokumente publike dhe atë; Listën e të gjithë mësimdhënësve të SH.M.L.T "Arkitekt Sinani" Mitrovicë e Jugut dhe lëndët që ata përfaqësojnë. |
| 22 | Egzon Dahsyla,<br><br>Gazetar në BIRN/Kallxo.com<br><br>01-034/01-0032607/24 | Elektronike | 14.05.2024 | 14.05.2024 | Qasje e Plotë | 16.05.2024 | Pala ka kërkuar qasje në informata dhe dokumente publike dhe atë; Procesverbalin e mbledhjes së Kuvendit Komunal të Mitrovicës së Jugut të mbajtur me dt. 26.12.2019; Vendimin e Kuvendit Komunal të Komunës së Mitrovicës së Jugut Nr. 02-060/01-0075387/19-5, dt. 29.08.2019; Propozim/Vendimin e Kryetarit të Komunës Nr. 02-030/01-011505/19, dt. 11.12.2019 për Këmbimin e Pronës së |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | Paluajtshme në pronësi të personit juridik NTP "Florenti" dhe çfarëdo dokumenti tjetër relevant që ka të bëj me procedurën e këmbimit të pronave të lartcekura. |
| 23 | Egzon Dahsyla,<br><br>Gazetar në BIRN/Kallxo.com<br><br>01-034/01-0036230/24 | Elektronike | 29.05.2024 | 29.05.2024 | Qasje e Plotë | 30.05.2024 | Pala ka kërkuar qasje në dokumentet publike që kanë të bëjnë me Planin Rregullues Urban Qendra dhe Planin Zhvillimor Komunal. |
| 24 | Blerim Carani<br><br>01-034/01-0038961/24 | Fizike | 07.06.2024<br><br>Në formë fizike e kam pranuar me datë 10.06.2024 | 10.06.2024 | Qasje e Pjesshme | 13.06.2024 | Pala ka kërkuar qasje në dokumente zyrtare për vlerësimin e tij dhe kundër kandidatëve dhe dokumentet e tjera për aplikim lidhur me përzgjedhjen e Drejtorëve dhe zv. Drejtorëve të institucioneve edukative arsimore në Komunën e Mitrovicës. |
| 25 | Iset Beka<br><br>01-034/01-0038970/24 | Fizike | 07.06.2024<br><br>Në formë fizike e kam pranuar me datë 10.06.2024 | 10.06.2024 | Qasje e Pjesshme | 13.06.2024 | Pala ka kërkuar qasje në dokumente zyrtare për vlerësimin e tij dhe kundër kandidatëve dhe dokumentet e tjera për aplikim lidhur me përzgjedhjen e Drejtorëve dhe zv. Drejtorëve të institucioneve edukative arsimore në Komunën e Mitrovicës. |
| 26 | Afërdita Sylaj Shehu<br><br>Drejtoreshë ekzekutive e "CBM"<br><br>01-034/01-0039926/24 | Elektronike | 12.06.2024 | 12.06.2024 | Qasje e Pjesshme | 13.06.2024 | Pala ka kërkuar qasje në dokumentet që kanë të bëjnë me rekrutimin/anulimin e procesit të përzgjedhjes së drejtorit të ShFMU "Musa Hoti" në Mitrovicë. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 27 | Ilmi Miftaraj<br><br>Përmbarues Privat në Mitrovicë<br><br>01-034/01-0039933/24 | Fizike | 12.06.2024 | 12.06.2024 | Qasje e Pjesshme | 26.06.2024 | Pala ka kërkuar qasje në dokumentet zyrtare. konkretisht;<br><br>1. Regjistrin me emrat e Përmbaruesve Privat me seli jashtë Komunës së Mitrovicës që kanë vendosur, zhvilluar dhe përfunduar procedurat përmbarimore ndaj debitores Komunës së Mitrovicës.<br><br>2. Numrin e rasteve të secilit përmbarues privat me seli jashtë Komunës së Mitrovicës që ka vendosur, zhvilluar dhe përfunduar procedurën përmbarimore ndaj debitores Komunës së Mitrovicës.<br><br>3. Të përfshihen në regjistër të gjitha rastet e dorëzuara si ato të dorëzuara në zyrën e pranimit të Komunës, ashtu edhe rastet e dorëzuara në komunë përmes postës.<br><br>Trajtimi i kësaj kërkese është bërë me afat shtesë prej 15 ditësh. |
| 28 | Ardian Begaj,<br><br>Ekspert gjyqësor i ndërtimtarisë<br><br>01-034/01-0040612/24 | Elektronike | 14.06.2024 është dërguar pas përfundimit të orarit të punës, andaj e njëjta ka filluar të shqyrtohet me datë<br><br>18.06.2024 | 18.06.2024 | Qasje e Pjesshme | 04.07.2024 | Pala ka kërkuar qasje në dokumente publike si në vijim;<br><br>Bazuar në vendimin e datës 13.05.2024;<br><br>1.Projektin e kanalizimit të ujërave të zeza për fshatin Zhabar së bashku me kontratën, situacionet e pagesave për punët e ekzekutuara, pranimin teknik dhe llogarinë përfundimtare të punimeve apo pranimin final të punimeve.<br><br>Për ato pjesë ku ka financuar Komuna e Mitrovicës qoftë direkt apo me bashkëfinancim me ndonjë institucion tjetër.<br><br>2. Informata lidhur me ndonjë impiant për trajtimin e ujërave të zeza nëse keni ndërtuar në këtë pjesë/zonë. Pra informata na duhen për të kuptuar se a ka derdhje të orientuara të ujërave të zeza në ndonjë pikë të caktuar, ku më pas trajtohen ujërat e zeza, prej rrjedhjeve tjera (atmosferike etj) që mund të jenë shkaktuar.<br><br>3. Informata lidhur me hapat e ndërmarrë nga Komuna e Mitrovicës për ndalimin e përmbytjeve të parcelave që janë objekt i kësaj padie. Pra çka ka ndërmarr Komuna juaj që të evitohen përmbytjet e këtyre parcelave qoftë nga rrjedhjet e ujërave të zeza, por edhe rrjedhjeve tjera të ujërave tjera (atmosferike etj) që mund të jenë shkaktuar. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | 4. Informata tjera relevante lidhur me investimet që mund ti keni bërë lidhur me trajtimin e përmbytjeve të këtyre parcelave apo edhe më gjerë.<br><br>Trajtimi i kësaj kërkese është bërë me afat shtesë prej 15 ditësh. |
| 29 | Emine Kaçiku<br><br>Avokate nga Mitrovica<br><br>01-034/01-0041145/24 | Fizike | 19.06.2024<br><br>Pala e ka paraqitur me këtë datë, ndërsa zyrtarja përgjegjëse për qasje në dokumente publike e ka pranuar në formë fizike me datë 21.06.2024 | 21.06.2024 | Qasje e Plotë | 25.06.2024 | Pala ka kërkuar qasje në dokumentacionet publike nga dosja nr. i protokollit 08-351/01-0075036/20/2 në emër të Bekim Vojvoda, sidomos është e nevojshme Vendimi i lejes së ndërtimit. |
| 30 | Fisnik Tmava<br><br>01-034/01-0041519/24 | Fizike | 20.06.2024<br><br>Pala e ka paraqitur me këtë datë, ndërsa zyrtarja përgjegjëse për qasje në dokumente publike e ka pranuar në formë fizike | 21.06.2024 | Qasje e Plotë | 26.06.2024 | Pala ka kërkuar qasje në dokumente publike që kanë të bëjnë me rrugën Shipol<br><br>1.Dokumenti- Formimi i komisionit përgjegjës për vend caktimin dhe shtrirjen e pengesave në rrugë. Po ashtu personi përgjegjës mbikëqyrësi teknik, i cili ka mbikëqyr punimet gjatë shtrimit të pengesave në rrugë.<br><br>2. Dokumenti- Projektin se ku kanë qenë të parapara shtrimi i pengesave në rrugë të specifikuara dhe të protokolluara. Si i kanë paraparë të shtrohen këto pengesa, vendet e specifikuara në projekt, dimensionet e tyre, nëse janë sipas standardeve të komunikacionit publik apo si e kanë paraparë rrezikshmërinë e vendosjes së këtyre pengesave nëse kanë marr pëlqim paraprak nga Ministria e Transportit dhe Postë Telekomunikacionit për vendosjes së pengesave në rrugë, pasi që kjo rrugë është rrugë magjistrale. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | me datë 21.06.2024 | | | | |
| 31 | Arbër Kabashi<br><br>01-034/01-0041818/24 | Elektronike | 21.06.2024<br><br>Data e parashtrimit nga pala,<br><br>Ndërsa me datë 24.06.2024 është protokolluar | 24.06.2024 | Qasje e Plotë | 10.07.2024 | Pala ka kërkuar qasje në informacione dhe dokumente publike si në vijim;<br><br>1.A ka pasur raste në institucionin tuaj që operatorët ekonomik kanë bërë kërkesa për ruajtjen e sekretit afarist në 3 vitet e fundit, sipas Aneksit 3, të dosjes së tenderit?<br><br>2. Nëse po, në sa raste dhe për cilët tender?<br><br>3. Kopjet e kërkesave për ruajtjen e sekretit afarist dhe vendimin për aprovimin apo refuzimin e kërkesës për ruajtje të sekretit afarist?<br><br>Trajtimi i kësaj kërkese është bërë me afat shtesë prej 15 ditësh. |
| 32 | Adela Bajrami Ibrahimi<br><br>01-034/01-0042844/24 | Fizike | 27.06.2024<br><br>Data e parashtrimit nga pala dhe data e protokollit<br><br>Ndërsa me datë 03.07.2024 e kam pranuar në formë fizike-Zyrtarja Përgjegjëse për Qasje në | 03.07.2024 | | | Pala ka kërkuar qasje në dokumentet zyrtare të personave të pranuar në listën e ngushtë të konkursit për "Zyrtar për çështje psikologjike" me numër reference; RN00013682.<br><br>Trajtimi i kësaj kërkese është në procedurë të shqyrtimit me afat shtesë prej 15 ditësh. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Dokumente Publike | | | | |

Vërejtje:

Të gjitha kërkesat e parashtruara si nga gazetarë, shoqëri civile, organizata buxhetore, individ, studentë apo të tjerë janë të arkivuara si dokumente fizike dhe dokumente elektronike.

Sofije Rushiti- Peci

Zyrtare Përgjegjëse për Qasje në Dokumente publike në Komunën e Mitrovicës

10/07/2024